Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО,
ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE;
T'EJTEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 94 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 123 | PRISHTINE, e dielle 11 Korrik 1948 | Çmimi 2 dinarë

Gjestet aventuriste te Qeveris se Shqipnis kundra interesave jetsore te popullit te Shqipnis

Nga notat e para, te botueme ne shtypin t'one, te cilat Qeverija e RFPJ ia dergoi Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis, asht mujte me u-parandie se nga ana e qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis po pregatiten disa masa, qe kane per qellim me i turbullue marrveshjet vllaznore e miqsore ndermjet dy vendeve t'ona aleate. Me 1 korrik 1948 erdhi nota me te cilen qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis i komunikon qeveris se RFPJ se i revokon te gjitha paktet ekonomike, marrveshtjet dhe protokolet, te cilat i lidhin dy shtetet dhe i konsideron ato si te pavlefshme e te pa-qenuna.

Pergjegja e qeveris s'one dhanun ksaj note dishmon se kjo ngjarje nuk mund te shqyrtohet e izolueme nga e tane fushata e rrenave shpifjeve e trillimeve te drejtueme n'adresen e Vendit dhe popujve t'one te cilet jane mesue me e kqyre ne sy çdo situate denjesisht dhe gjakftofteisisht.

Dihet se ndihma qe ia ka dhane qeverija e jone, dhe te gjitha paktet qe Jugosllavija e re i ka lidhe me Shqipnin e kane forcue pozitat e Republikes Popullore te Shqipnis kundra qellimeve t'imperjalistave perendimore dhe mbeturinave t'influences se tyne ne Shqipni. Keto kane qene shembuj i vendosjes se marredhanjeve dhe ndihmes reciproke te vendeve te demokracis se re ne lufte per ndertimin e socjalizmit dhe perforcimin e paqes dhe te forcave te demokracis. Dhe bash keshtu e kurrqysh tjeter, edhe masat punuese dhe populli Shqipnis e kane pranue ket bashkepunim dhe ndihme qe ia ka dhane Jugosllavija e Titos Republikes Popullore te Shqipnis.

Pakti mbi miqesin dhe ndihmen reciproke ndermjet Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe te Republikes Popullore te Shqipnis, i nenshkruem ne Tirane qysh me 9 korrik 1946, ka qene konfirmim i deshires se popullit te Shqipnis dhe popujve te Jugosllavis, te cilet me ket akt solemn legalizuen fitoren e korrun mbi anmiqet e jashtem e te mbrendeshem te vllaznimit dhe bo[illegible] rasis. Ky pakt ka dashte me thane njikohsisht vendosmeni ne lufte te pameshirshme kundra kujtdo qe do te provonte me e rrezikue qofte edhe pjesen ma ta vogel t'asaj qe popujt t'one fituen ne luften e tyne te perbashket.

Ne baze te ktij paktit popujt t'one kane marre mbi vehte obligime te mdhaja.

Pakti mbi koordinimin e planeve ekonomike, mbi unjonin doganuer dhe mbi barazin e valutave i nenshkruem me 27 nanduer 1946, i ka caktue ne menyre te kjarte rruget e bashkepunimit t'one.

Qysh ne muejin korrik 1946, ndermjet qeverive te te dyja vendeve jane arrijte marreveshtjet mbi krijimin e shoqnive mikste ne baze te paritetit me gjithse qeverija e jone nuk i pritet kesaj forme te bashkepunimit. Por, shkalla e madhe e mbrapambetjes se trashigueme, mungesa e madhe e kuadrave ne Shqipni si dhe mungesa e eksperjences n'organizimin dhe udhheqjen e degve te ndryshme ekonomike, kane lejue vetem ne ket forme bashkepunimi reciprok çfrytzimin e vertete dhe te drejte te ndihmes qe Vendi i yne duhet t'ia epte ne maqina, vegla materjale investimi dhe kuadra profesjonale per t'a ndalue humbjen e matutjeshme te forcave produktive qe ekzistojne ne Republiken Popullore te Shqipnis dhe me e ba te mundshem çfrytzimin racjonal dhe zhvillimin e tyne te shpejte. Ket forme te qeverisjes se perbashket te shoqnive mikste te dyja palet e kane aprovue tue marre si shumbull formen e shoqnive mikste sovjetike, te formueme mbas çlirimit ne disa vende te demokracis popullore. Mirepo, qeverija e jone ka konsiderue se ndihma per zhvillimin e ekonomis popullore te Shqipnis do te realizohej ma se miri ne qofte se ne vend te dhanjes se kontributit ne shoqnit mikste t'i bahej e mundun Republikes Popullore te Shqipnis qe, me ane te krediteve te dhanuna nga ana e Jugosllavis, te jete pronare e te gjitha investicjoneve te ketyne shoqnive, çka do te thote te disponoje me te gjitha rezultatet financjare te veprimtaris se ketyne shoqnive. Keshtu, ne kuadrin e kredis prej 2 miljarde dinarve qe i jane dhane Republikes Popullore te Shqipnis ne vitin 1947 asht ba e mundun qe me ane te saje te sigurohen investicjonet e duhuna per zhvillimin e shoqnive mikste, si nga prodhimi i Jugosllavis ashtu edhe nga importimi, per te cilin Jugosllavija, mbrenda mundesive dhe nevojave te parapame me planin e investimit te shoqnive te permenduna, do t'i siguronte devizat.

Ne lidhje me shoqnin per nafte, ase me shoqnin e xeheroreve, Jugosllavija p. sh. ka hjeke dore nga 50% ase 15% te fitimit te ketyne shoqnive,ne dobi te Republikes Popullore te Shqipnis per koncesjonet e dhanuna n'eksploatimin e naftes ase pasunis minerale, e pjesa tjeter e fitimit do te ndahej simbas kontributeve te njenes e tjetres pale, qe praktikisht don me thane se fitimi gadi ne tanesi i asht lane Republikes Popullore te Shqipnis.

Se çfare dobije ka pase ekonomija e Shqipnis prej shoqnive mikste ket e tregon edhe ndertimi i hekurudhes Durres—Peqin 30 kilometra te gjate per te cilen Jugosllavija ka sigurue te tane materjalin investiv, te tane kuadrin profesjonal, teknik e administrativ. Po keshtu ka qene sigurue edhe ndertimi investicjonal i centralit hidraulik—Selita e Madhe—afer Tiranes per territorin e Tiranes dhe Durresit, te cilen e ka krye sipermarrja jugosllave „Hidrogradnja" me personelin dhe te tane mekanizmin e saje. Ky central zgjidhe njikohsisht edhe çashtjet e furnizimit te Tiranes me uje. Me ndihmen e ekspertave jugosllav dhe me ane te krediteve ne vjetin 1947 e 1948 perseri asht organizue dhe zgjanue per disa here nxjerrja e naftes ne bazenin e lanun mbas dore Patos dhe asht permirsue bukur mire prodhimi dhe perpunimi i naftes ne Kuçove, asht permirsue prodhimi i bakrit dhe asht ba e mundeshme qelja e minjerave te reja te kromit. Vetem keta disa shembuj tregojne kjartas se çka ka ba Jugosllavija per ngritjen e ekonomis popullore te Shqipnis. Keto fakte jane aq te kjarta sa nuk mund te fshihen as ne Shqipni as ne boten e jashtme. Keto vetvetiu demaskojne rrenat e paturpshme se gjoja shoqnit-mikste jane perdore si mjet i qeveris se RFPJ per çfrytzimin Shqipnis, aq ma pare sepse te gjithe udhheqsat dhe gazetat e Shqipnis deri vone e kane njofte plotsisht punen dhe sukseset e ketyne shoqnive mikste.

Perveç investicjoneve qe i ka sigurue qeverija e RFPJ per shoqninat mikste, ajo ka sigurue edhe ndertimin e shum fabrikave, si, p. sh. fabrika e sheqerit ne Korçe, fabriken e marmalates n'Elbasan, fabriken e konopli ne Rogozhine, fabriken per perpunimin e linit ne Rogozhine ,fabriken e tekstilit, shtypshkrojen etj.

Ne baze te krediteve, te cilat i ka dhane Jugosllavija ne kuadrin e t'ardhunave dhe te dalunave te planifikueme me buxhet, asht ba e mundeshme qe ekonomija e Shqipnis te kaloje ne rrugen e ekonomis me plan, asht balancue buxheti shtetnuer, asht

(vazhdon ne faqen e dyte)

Regjistrimi i Huas popullore

Deri ne mbramjen e dates 9 korrik, ne Krahinen t'onë janë regjistrue gjithsejt 109 576.000 dinarë

Rrethi i Mitrovices	11.985.000 din.
„ „ Gjakoves	11.126.000 „
„ „ Rahovecit	8.481.000 „
„ „ Pejes	7.956.000 „
„ „ Ferizajit	7.594.000 „
Qytoti i Prishtines	7.370.000 „
Rrethi i Liplanit	6.239.000 „
Rrethi i Gjurakoveit	5.453.000 „
Qyteti i Mitrovices	5.064.000 „
Rrethi i Gilanit	4.871.000 „
Rrethi i Serbices	4.727.000 „
Qyteti i Prishtines	4.300.000 „
„ „ Pejes	3.974.000 „
Rrethi i Prizrenit	3.706.000 „
„ „ Suharekes	3.370.000 „
„ „ Vuçiternes	3.361.000 „
„ „ Podujeves	2.839.000 „
„ „ Prizrenit	2.775.000 „
„ „ Kamenices	2.442.000 „
„ „ Dragashit	1.943.000 „

Ne ndere ta Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis

Frontistat e Babushit, Gadimles e te Magures punojne edhe naten per ndertimin e shtepive kooperative

Njimdhete brigada pune, qe perbahen prej 60 kompanive, jane tue punue vazhdimisht per ndertimin e shtepijave kooperative ne rrethin e Liplanit. Deri tash jane vue temelet e shtepijave kooperative ne Bushtertce,Sllovinje, Sedllas, ndersa ne vendet Gradsko, Muzhiçan, Janjeve, Shtimle, Liplan jane tue u-ndertue muret. Vetem frontistat e Radeves kane ngele mbrapa. Frontistat e ketij katundi duhet te marrin shembull nga frontistat e Babushit, Gadimles dhe te Magures, te cilet punojne edhe naten per kryemjen e shtepive kooperative.

Ne rrethin e Dragashit po shpejtesohet ndertimi i shtepijave kooperative

Ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, populli puntor i rrethit te Dragashit e ka shpejtesue punen per ndertimin e shtepijave kooperative. Populli i Llopushnikut i ka vue temelet e shtepis kooperative dhe ka marre persiper me e krye se ndertuemi deri ne diten e mbajtjes se Kongresit.

Populli i Brodosavcit, tue i hjedhe poshte akuzat qe i jane ba Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito, ka marre mbi vedi obligime te reja, keshtu qe me daten 21 korrik do te kryej ndertimin e shtepis kooperative.

Rinija e rrethit t'Istokut po i plotson obligimet e marruna persiper

Brigadat puntore te rinis te rrethit t'Istokut punojne aktivisht ne plotesimin e detyrave te veta te parakongresit. Veçanerisht asht permiresue puna ç'prej keshillimit te kryetarve t'aktivave te rinis. Ne Gjurakovc, Dobrushe, Osojan, Vrelle dhe Rakosh, çdo te dyten dite punon nga nji çete puntore ne ngritjen e shtepijave kooperative.

Me 27 qershuer rinija e rrethit t'Istokut e ka fillue akcjonin e mbjes se misrit. Ajo ka mbe afro 2 hektare miser, nja nji gjysem hektari lule dielli dhe qepe, 35 are rrepa sheqerit. Ate dite te rijt kane ba edhe afro 2.800 metra hasherim rranze rrugve.

Rinija ka marre pjese ne marrjen e filmit dokumentar ne rrethin e Istokut.

Rinija e rrethit t'Istokut punon ne rregullimin e fidanishtes se re. Ajo ka hape kanalin e ri ne gjatesi prej 2.900 metra, te thelle 70 e te gjane gjane 50 centimetra. Ajo ka mbjelle 36 lehe qepe, 200 metra katrore rrepa sheqeri dhe rreth fidanishtes bagrema ne gjatesi prej 1.500 metrah.

Grate antifashiste te Pejes per realizimin e obligimeve te marr u-na persiper

Grate antifashiste te qytetit te Pejes i jane pervesh punes per realizimin e obligimeve te marruna persiper ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Ma se njiqind gra shqiptare, serbe e malazeze punojne per çdo dite nga tri ore ne vendin e nxjerrjes se tullave dhe ne ndertimin e dispanzerit antituberkuloz. Deri tash keto kane transportue ne vendin e ndertimit ma se tre vagona tulla. Gjashtdhet e peivjeçarja Shema Drakulloviq ka transportue fill vetem, per 80 ore pune, ma se 11.000 cope tulla. Edhe grate tjera bajne gara ndermjet vedi per realizimin dhe tejkalimin e obligimeve te marruna persiper. Grate e ketij qytetit kane marre pjese masovike ne ndertimin e rruges se re te qytetit, ne mbjen e kopshtit te femijve, ne pastrimin e kanaleve etj.

Grate e rrethit jane tue e ndihmue ndertimin e shtepijvet kooperative. Ne kete pune dallohen grate e keshillave te vendeve Gorazhdeve dhe Rugove. Grate e ketij rrethi kane dhane deri tash ma se 8.000 ore pune vullnetare dhe kane nxejrre 170 meter kub gure. Ne punime marrin pjese se bashku grate shqiptare me ato serbe, malazeze. Grate e keshillit te vendit Baran jane zotue me i dhane gjasht kopshte per kuzhinat e shkolles, te shtepis se femijve dhe per vend verimin e femivje.

Frontistat e Ferizajt do te ndertojne centralin elektrik

Nji nga obligimet e parakongresit te frontistave te Ferizajt asht ndertimi i centralit elektrik. Ne ndertimin e kanalit per telat gjate qershorit kane punue 537 frontista, nga te cilet 30% kane qene gra. Ne kanal jane shpenzue 2.252 ore pune dhe asht krye me 29 qershuer. Grate e Ferizajt vazhdojne punen ne ndertimin e parkut te qytetit, ne te cilin ato kane dhane deri tash 3.100 ore pune. Ne ket akcjon ma mire punojne grate antifashiste te rejonit te pare, te cilat kane dhane 1.150 ore pune.

Brigada e pare e Zveçanit u shpalle gara brigadave ne km. 51

AUTOSTRADA BEOGRAD-ZAGREB

Brigada e pare e Zveçanit, e cila gjindet ne ndertimin e autostrades Beograd-Zagreb, arrine rezultate te mdha ja ne pune. Ne brigade deri tash tane shpalle 17 sulmuesa, e 18 jane lavdrue. Ajo, per 56 dite e ka tejkalue normen aproksimativisht per 65% çdo dite, per ndere te Kongresit te Peste te PKJ, i ka ftue per gara te gjitha brigadat ne kilometrin 51 te seksionit te pare t'autostrades. Asht obligue se do te rrije edhe 4 dite mbas afatit tremujuer; çdo dite t'a tejkaloje normen per 66%, t'a zhduke analfabetizmin ne brigade, te lexoje 275 libra, te jape per shtepin foshnjore ne Mitrovice 1.500 dinare; 95% te brigadirve do te marrin pjese ne regjistrimin e Huas popullore, ne garat fiskulturale dhe ushtrimet paraushtarake do te jene ma te mirat ne akcjon e pasterti ne kilometrin 51 t'autostrades.

Gjestet aventuriste te Qeveris se Shqipnis kundra interesave jetesore te popullit te Shqipnis

(vijon nga faqja e pare)

sigurue forcimi i fuqis mprojtese dhe zhvillimi i ushtris popullore, ka lidhun ndertimi i gjane dhe i shumllojshem investicjonal, asht ba i mundshem prodhimi i zgjanuem e me forcizim ne lande te para dhe gjymes-fabrikatesh—çfrytzimi ma i mire i kapaciteteve te tashme. Me keto kredite asht arrijte shtimi i konsiderueshem i t'ardhunave popullore, asht ba i mundeshem shtimi i rrogave te nepunesve shtetnore dhe puntorve, asht shtue akumulimi dhe, veç tjerash, asht ngrite standardi jetesuer. Buxheti mbi saje te kesaj ndihme nga Jugosllavija, buxheti shtetnuer i Shqipnis per vjetin 1947, per here te pare mbas lufte, asht mbylle jo vetem pa deficit, por edhe me suficit prej afer 100 miljone lekve.

Tkunjet e qeveris se Shqipnis, se gjoja qeverija e Jugosllavis nuk i ka krye besnikisht dhe si duhet obligimet e saja ne baze te pakteve te lidhuna-jane krejt arbitrare. Perkundrazi, ne se ndonjeni prej ketyne pakteve deri tash nuk asht krye plotsisht, ky ka qene faj i qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis, e cila ase nuk i ka krye obligimet e saja, ase bile edhe ka pengue zbatimin e duhun te tyne.

Persa i perket kredis prej 2 miljarde dinarve, me te cilen Jugosllavija simbas marreveshtjes se korrikut te vjetit 1947, ia ka ba te mundshme Shqipnis me marre mallna per investicjone, riprodhim dhe konsumim te gjane prej Jugosllavis dhe, me devizat e Jugosllavis, ne boten e jashtme, e verteta gjendja asht kjo:

Jugosllavija i ka dhane Shqipnis, pa ndonji marreveshtje te perparshme, gjate gjysmesvjetorit te pare te vjetit 1947, mallna me nji vlere prej disa qinda miljona dinarve.

Deri ne fund te vjetit 1947, ne baze te kesaj kredije, Shqipnija ka lidhe pune me nji vlere prej 1.000.000.000 dinaresh, e restoja prej 400.000.000 dinaresh ka qene parapa si rezerve per porosinat e mavonshme.

Prej kesaj Jugosllavija i ka dorezue Shqipnis mallna dhe materjal me nji vlere prej 1.350.000.000 dinaresh, ase 90% te sa asht parapame. Persa i perket restos, faji qendron ne paraqitjen e ngadalshme dhe jo me kohe te kerkesave te Shqipnis dhe n'aparatin e saje jo mjaft t'aftesuem ekonomik.

Shkaqet ma te thella per moskryemjen e ketyne obligimeve qendrojne ne pengimin me qellim te zgjanimit te lidhjeve ekonomike ndermjet Jugosllavis e Shqipnis, gja qe asht shpreh sidomos ne vjeshten e vjetit 1947 nga ana e nji pjese t'udheheqsave pergjegjesa te Shqipnis.

Pasojat e gjith kesaj u çfaqen edhe ne tremujorshin e pare te vjetit 1948, bash atehere kur duhet dhe mund te mbrrinte malli, qe Shqipnija duhet t'a porosite ne vjetin 1947.

Derisa nga nji ane Vendi yne ia ka dorezue Shqipnis vleren prej ma se 1.600.000.000 dinarve, prej Shqipnis ka marre njikohesisht vleren prej jo plot 150.000.000 dinarve, qe nuk paraqet as perpjestimin 1:10. Ketu, natyrisht, nuk asht llogarite ndihma prej 32 miljone dinarve, te cilen ia kane dhane popujt t'one popullit te Shqipnis me rastin e inondates ne vjetin 1946 dhe as malli prej 124 miljona lekve, per transferten e pagimit te kapitalit themelor te shoqnive mikste dhe per banken mikste jugosllavo-shqiptare.

Mandej, Jugosllavija ka aprovue per Shqipnin kredine prej 3 miljarde dinarve per vjetin 1948, me kusht qe ne kuadrin e kesaj te llogaritet edhe ai malli i vjetit 1947 i cili, per arsyenat e naltpermendura, asht dorezue ne vjetin 1948. Ne baze te kesaj, Shqipnija, per gjysmevjetorin e pare, ka lidhe afro 750.000.000 dinare importime nga prodhimi i yne i mbrendeshem. Prodhuesat jugosllave deri ne fund te qershorit kane dorezue 90% te mallnave te porositura, te cilat kane mberrijte ne Shqipni ase gjinden ne rruge, ne menyre qe ne dekaden e pare te dorezohet edhe 10%-jt e restos se mallit.

Ne muejin maj te ketij vjetit, Jugosllavija ka pranue jo vetem me e dorzue kontingjentin vjetuer te mallit te parapame me plan ne muejin kallnuer, por e ka pranue edhe porosin e pastajshme te Komisjonit te planit te Shqipnis, si ne materjalin deficitar asht edhe ne materjalin e nevojshem per çfrytezimin ma te mire te kapacitetit t'industris se Shqipnis dhe dishmoi perseri se asht e gatshme me e shtue ndihmen e saje per zhvillimin ma te shpejte te Shqipnis. Derisa qeverija e FRPJ ka ba çmos qe malli i kontraktuem ne gjysmevjetorin e pare t'i dorezohet me kohe Shqipnis, gja qe praktikisht edhe e ka realizue, me gjithse me faj te Shqipnis n-vonue lidhja e kontrates si ne tremujorshin e pare ashtu edhe ne te dytin, qeverija e R. P. te Shqipnis nuk ka tregue kurrfare vullneti te mire, por, perkundrazi, ka evitue çdo caktim t'obligimeve te domosdoshme.

Ne vitin 1948 Qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis i asht dashte me i hape Jugosllavis nji kredit prej nji miljardi. Fakti asht se Shqipnija s'e ka percaktue fare planin e eksportimit te mallnave te veta per Jugosllavi, por deri edhe detyrimet qe i kane marre perfaqesuesit e saje ne kallnuer shum here i ka ndryshue dhe ne Jugosllavi, per ate kohe, ka eksportue gjithsejt 240 miljone dinare mallna, pa dashte me i permbajte as terminave fikse, as kualitetit te mallit.

Me gjithe kete qendrim ilegal e inkorrent ne çashtjet ekonomike, qeverija e Republikes Popullore te Shqipnis prap se prap kerkoi nga Jugosllavija per kuartalin e trete e te katert, koncesjon te ri, d. m. th. lidhjen direkte te kontratave ne mes te konsumuesve te Shqipnis dhe prodhuesve Jugosllave. Kur qeverija e jone e muer parasysh ket kerkese, perfaqesuesit e konsumatorve te Shqipnis me te vertete e lidhen kontraten per krejt „gjysemvjetorin e dyte.

Keshtu asht gjendja reale ne lidhjen me permbushjen e detyrimeve nga ana e Jugosllavis ne gjysemvjetorin e pare te vjetit 1948 e i ketille asht qendrimi i qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis ne lidhje me detyrimet n'ate periudhe.

Per sigurimin e standardit jetesuer ma te mire te masave te gjana te Shqipnis, qeverija e jone i ka dorzue Shqipnis 5.000 tonelata drithe, e njimije tonelata tagji per kuaj t'ushtris ne nji kohe kur, edhe Jugosllavija i ka pase punet ma se keq me drithe, e me gjithse s'ka pase ktu kurrfare obligimi.

Mandej, qeverija e jone, nga ana e saje, ka ba çmos qe te krijoheshin kushtet per barazimin e çmimeve, tue pase parasysh se, per shkak te nibra pambeltjes dhe shpenzimeve ma te mdhaja te prodhimit si dhe çashtjes se parregullueme te transportit, e pa mundshme per te gjithe artikujt e prodhimit te vendit te Shqipnis e sidomos artikujt bujqesore me zbatue çmimet e unjishme qe jane ne fuqi ne Jugosllavi. Per kete qellim qeveris se Shqipnis i jane propozue masa konkrete ne kuadrin e luftes per mbajtjen e çmimeve te caktueme, por keto propozime nuk jane marre parasysh, e prandaj per keto rrjedhime asht pergjegjese vetem qeverija e Shqipnis. Simbas deklaratave te vet perfaqsuesve te qeveris se Shqipnis ne komisjonin e koordinimit asht arrijte gjithnane dhe per çdo gja marreveshtja, pra edhe persa u perket çmimeve t'artikujve t'eksportimit te Shqipnis per deri ne muejin qershuer, kur ende nuk kane qene caktue definitivisht çmimet veç per tre artikuj. Prandaj pretekstet ne lidhje me koordinimin e çmimeve kane po at kuptim si dhe e tane fushata e trillueme dhe gjithe kundra Jugosllavis. Simbas çmimeve te propozueme per eksportimin e mallnave te Shqipnis ne Jugosllavi do te paraqitej bilanci prej ma se 14 miljona dinaresh ne dobi te Shqipnis bile vetem si ndryshim ndermjet çmimeve simbas te cilave Jugosllavija ka pranue me i ble prodhimet e Shqipnis dhe çmimeve te mbrendeshme te Shqipnis, tue mos marre parasysh keto kualitetin e dobet te prodhimeve. Jugosllavija ka pranue edhe shpenzime shum ma te nalta te shum prodhimeve te Shqipnis siç asht p. sh. rasti me bakrin e Shqipnis, i cili kushton tri here ma shtrejte se bakri ne tregun botnuer. Jugosllavija ka ble dhe asht e gatshme me i ble prodhimet e Shqipnis, nder to edhe bakrin, me çmime te formueme mbi shpenzimet kaq te nalta te prodhimit. Ky fakt tregon, pamvaresisht nga te gjitha te tjerat, qe udheheqesija shtetnore e Shqipnis—kur ka ba shpifje dhe ofendime kundra Jugosllavis dhe popujve te saje—ka harrue se populli i Shqipnis me te vertete do t'ishte i çfrytezuem, po te mos kishte qene ndihma e gjithaneshme qe ia ka dhane Jugosllavija.

Ne kuadrin e kredis prej 3 miljarda dinarve Jugosllavija duhej t'importonte ne Shqipni nga bota e jashtme mallna me nji vlere prej ma se 700 miljona dinarve. Ne gjysemvjetorin e pare Shqipnija ka porosite me ane te sipermarrjeve tregtare te Jugosllavis mallna nji vlere prej afro 140 miljona dinaresh. Me gjithse keto porosina kane mberrijte vone, prap se prap Jugosllavija ka sigurue ne gjysemvjetorin e pare mallnat me nji vlere prej ma se 50 miljona dinaresh, qe don me thane ma se 35% me gjith te tana veshtirsinat qe i jane paraqite Vendit t'one me rastin e blejmes perjashta. Edhe shoqnis mikste per nafte i jane lane ne dispozicjon afro 140 miljone dinare ne deviza per me sjelle mallna nga bota e jashtme.

Njikohesisht, Jugosllavija ka marre per mallin e dorzuem, nga Shqipnija afro 10 miljona dinare ne deviza, ndersa ne ket periudhe vetem per shpenzimet e transportit dhe si qira per vendin e zanun n'anijet e hueja ka dhane ne deviza ma se 15 miljona dinare. Ne vjetin 1947 simbas marreveshtjes tregtare, Jugosllavija, per hesap te Shqipnis, me ane te sipermarrjeve te saja tregtare ka krye shitjen e mallit te Shqipnis ne boten e jashtme ne menyre komisjonare, tue ia lejue Shqipnis me i perdore devizat lirisht, keshtu qe edhe sot gjindet ne llogari te saje saldoja e pashpenzueme aktive e devizave, me gjithse Jugosllavija njikohesisht ka marre mbi vehte obligimet kaq dermuese me gjete ne boten e jashtme mallna qe i nevojiten Shqipnis. Fakti se per blemjet investive nga bota e jashtme Jugosllavija duhet te paguej perpara deri 30% e edhe ma shum vlere te mallnave te porositura ne te gjitha vendet kapitaliste pa perjashtim, e bile edhe ne vendet e demokracis popullore, ku ka ba keso porosinash, provon jo vetem veshtiresinat rreth blemjes se ketyne materjaleve, por edhe kuptimin dhe qendrimin e singerte vllaznor te Jugosllavis ndaj Shqipnis.

Per t'i zbatue si duhet te gjitha paktet ekonomike ndermjet te dyja vendeve asht formue Komisjoni koordinues Shqiptaro-Jugosllav. Praktika njivjeçare e qenjes se Komisjonit koordinues ka tregue se kjo forme organizative, ne trajtat e ketilla te bashkpunimit ne mes te Republikes Popullore te Shqipnis dhe RFPJ per ngritjen e ekonomis me plan dhe per ndertimin e socjalizmit-siç asht konstatue ne marreveshtjet dhe paktet ne faqi-asht e drejte, e dobishme dhe e nevojshme. Per shkak te qendrimeve jo te singerta te perfaqesuesave te Shqipnis, Komisjoni koordinues, ne vjetin 1947 nuk ka mujte me iu pergjegje plotesisht detyrave te tija.

Persa i perket Komisjonit dhe ekspertave jugosllave e punes se tyne ne sekretarijate te cilat, simbas kerkeses se te dyja palve, kane qene formue prane Komisjonit koordinues, si dhe persa i perket ndihmes qe e kane dhane ekspertat t'one me kshillimet e tyne per zgjidhjen e problemave ekonomike, deri me 10 qershuer te ketij vjetit nuk asht thane kurgja e keqe, por perkundrazi, egziston nji seri deklaratash t'udheheqsave ma te nalte te gadi te gjithe sektorve ekonomike te Shqipnis, te cilet e kane çmue nalte punen e ketyne ekspertave dhe kontributin e tyne per rregullimin e gjendjes ekonomike.

Kur dihet e tane kjo, atehere del e kjarte se çpifjet, me te cilat dishrojne me e paraqite ndryshej qellimin e formimit dhe randesin e punes se Komisjonit koordinues, jane kurdise me qellim te keq nga te njejtat shtytje prej te cilave ka dale i tane ai ofendim kundra Vendit t'one.

Se te gjitha keto trillime nuk kane kurrfare lidhjeje me egzistencen e marredhanjeve te vertela dhe me paktet e bashkpunimit ndermjet te dyja vendeve, ma se miri e din vet populli i Shqipnis i cili e ka ndie ngritjen e standardit jetesuer dhe t'ekonomis se tij. Faktet e ketilla i kane detyrue udheheqsat pergjegjsa te Shqipnis t'a çmojne drejte, kur kane dale para popullit, randesin e kesaj ndihme per popullin e Shqipnis dhe per Republiken e tij popullore, per pamvaresin e vendit, per ngritjen e standardit jetesuer te tij, etj.

Keshtu, Enver Hoxha, qysh me 1 kallnuer 1948, ka thane: "Me popujt heroike te Jugosllavis se re te mareshalit Tito-garantues i liris, pamvaresis dhe sovranitetit te popullit t'one dhe te gjithe popujve tjere ballkanike, jemi te lidhun me vllazimin dhe bashkimin te pathyeshem i cili ia ka sigurue vendit t'one ndihmen bujare dhe vllaznore si ne kohen e luftes ashtu edhe tash, ne rindertimin e gjithanshem te Vendit t'one". Po ket ide e ka çfaqe Enver Hoxha edhe ne mbledhjen e fundit te Kuvendit popullor te Shqipnis, me 12 maj te ketij vjetit: "Populli yne per dite ma teper do t'a forcoje dhe çelnikose vllazenimin, miqesin e çmueshme dhe aleancen me popujt vllazen te Jugosllavis se mareshalit Tito, krah per krah me te cilet ka luftue per te fitue lirin, dhe tash, krah per krah me te cilet, punon per ndertimin e jetes se perbashket ma te mire".

Ne diskusjon mbi buxhetin, ne mbledhjen e Kuvendit popullor ne kallnuer, ministri i industris se Shqipnis Tuk Jakova ka thane se ekzistenca e miqesis me Jugosllavin dhe "ndihma vllaznore qe na e kane dhane ata po kursim gjat luftes" ka perfaqesue, mbas egzistences se Bashkimit Sovjetik si faktor kryesuer, "rolin ma te randesishem per krijimin dhe ruejtjen e qindrueshme te pushtetit popullor ne vendin t'one".

Ne fillim te qershorit te ketij vjetit, ministri i industris Tuk Jakova, tue i numerue fabrikat e reja te ndertueme ne Shqipni, ka thane: "Nuk guxojme me harrue se per fabrikat e reja ndihme te madhe na kane dhane popujt miqe e vllazen te Jugosllavis. Gjithashtu, kane ardhe me na dhane ndihme te madhe ne nderitjen e ketyne fabrikave puntoret, teknikat dhe inxhinjerat jugosllav".

Ministri i Arsimit te Republikes Popullore te Shqipnis, Mahmut Dume, ne muejin maj te ketij vjetit ka shkrue: "Ne krye te popujve qe kane luftue per çlirimin e tyne, qe kane luftue per t'u çlirue nga zgjedha e okupatorit fashist, ka qene Jugosllavija e Titos. Partija Komuniste e Jugosllavis e ka zbatue ma mire se çdo parti tjeter, simbas kushteve ne vendin e vet, doktrinen e Markșit, Engelsit, Leninit e Stalinit. Na kemi mesue shum prej popujve te Jugosllavis dhe duhet te mesojme akoma ma teper, sepse vendet t'ona ndertojne socjalizmin nen te njejtat kushte".

Te gjitha keto deklarata jane dishmi se udheheqsat e Shqipnis nuk kane mujte me e mshefe para masave popullore gjendjen e vertete dhe randesin e ndihmes qe ia ka dhane popullit te Shqipnis Jugosllavija e Titos. Mbasi mbrapa shpinde kane qene te njoftun me pregatitjet qe kane sjelle fushaten çpifse kundra Jugosllavis, kur filloi kjo fushate ata i kurdisen kriminalisht akuzat kundra Jugosllavis, si e si t'a lekundin besimin e popullit te Shqipnis ne bashkpunimin dhe ndihmen e singerte qe ia ka dhane Jugosllavija, tue mos u-kujdese me ket rast as per interesat e popullit te Shqipnis as per obligimet nderkombetare qe burojne per Shqipnin nga paktet e ratifikueme prej te dyja palve.

Kuptohet se te gjitha pasojat e gjestit te ketille brutal e te paprovokuem prej kurrkujt, do t'i bijne vetem qeveris se Republikes Popullore te Shqipnis. Ky gjest i paturpshem qe shkele deri edhe parimet ma elementare te plotesimit te ndershem t'obligimeve te Republikes Popullore te Shqipnis, asht i padeje per sakrificat dhe perpjekjet qe i ka dhane populli i Shqipnis per lirin dhe ndertimin e vendit te vet.

Polera e mjere dhe e trente mbi imperjalizmin e Jugosllavis se re, mbi qellimet robnuese te cilat gjoja do t'a kthejshin Shqipnin ne koloni, dishmon se nuk bahet kurrfare kujdesi per interesat themelore te zhvillimit dhe forcimit te fuqive t'ekonomis se Shqipnis, por me to supozohen interesa krejt te tjera qe nuk mund te kene korrgja te perbashket me interesat e blokut anti-imperjalist demokratik **„Borba 6 korrik 1948"**.

Te bajmë çmos qe korrja dhe fshimja e drithnave te bardhë të kryhet në kohen e duhun

Gjindemi perpara fushates kryesore te korrjes se drithnave: grunit, elbit, tershanes dhe thekres, e per se shpejti do te filloje edhe fshimja.

Koha ma e pershtatshme per korrjen e ketyne drithnave asht po sa te filloje me u-verdhe kallini dhe kashta. Disa bujqe te Krahines s'one e kane per zakon qe keto drithna t'i korrin mbasi te piqen shum. Kjo asht e dameshme, sepse drithnat qe lihen me u-pjeke per se tepermi derdhen ma teper dhe humbjet jane te mdhaja, e veçanerisht ne grune e thekren. Ne qofte se e marr m minimumin se ne Kosmet, me rastin e korrjes se drithnave te pjekuna teper, derdhen ma se 50 kgr. per nji hektar, do te shofim se ne te gjithe Krahinen t'one mund te kemi nji humb je prej 300 vagonash. Prandaj drithnat duhet me i korre ne kohen e duhun dhe mos me i lane me u-pjeke se tepermi.

Te gjitha organizatat masovike duhet t'angazhohen ne fushaten e korrjes se drithnave, te formojne brigada pune per korrjen e arave te te gjithe atyne qe jane te pandihmesa ase pa fuqi puntore. Gjithashtu, duhet me e organizue mbledhjen e shpejte te duejve nga ara dhe me njiheré me e ba pastrimin e sternishtave, sepse edhe kjo asht nji mase per produktivitet ma te madh. N'anen tjeter, duhet me u-kujdesue rreth sigurimit te fuqis puntore per maqinat fshise dhe me i kushtue kujdesin e duhun kualitetit te punes dhe realizimit te normes ditore.

Kryemja e korrjes dhe e fshimjes, ne kohen sa ma te shpejte, asht nji nga çashtjet me randesi te dores se pare, prandaj ky aksjon duhet te merret me plote seriozitet si nga ana e te gjithe keshillave popullore, ashtu edhe nga te gjitha organizatat popullore.

Stacjoni i maqinave ne Peje i ka ndreqe garniturat 98 %

Stacjoni i maqinave dhe i traktorave ne Peje i ka ndreqe maqinat e veta per 98 per qind dhe asht gadi me fillue nga puna ne gjashte rrethet qe i perkasin. Pjesa tjeter prej 2 per qind do te ndreqet po sa te mberrijne disa vegla te porositura. Grupet puntore bajne gare ndermjet vedi se kush do te punojne ma shpejt e ma mire. Kontrolloret teknike, brigadieret dhe traktoristat jane tue ba prova praktike dhe jane tue i largue te metat e maqinave aty per aty. Se shpejti do te dalin ne teren edhe maqinat per pastrimin e sernishtave.

Prane stacjonit asht mbajte nji kurs njimë dituer per udheheqsat e maqinave korrese dhe vete-lidhese. Kursistat kane ba edhe mesime praktike. Maqina „Harvak" ka fshie per nji minut 35.000 kgr. elb. Ky efekt asht mberrijte ne saje t'organizimit te mire te punes.

Ne te gjitha qytetet dhe rrethet e Krahines s'one mbahen konferenca te Partis, ne te cilat zgjedhen delegatet per Kongresin e peste te partis Komuniste te Jugosllavis

Ne te gjitha qytetet dhe rrethet e Krahines s'one mbahen konferenca te Partis, ne te cilat antaret e PKS te Kosmetit zgjedhin delegatet per Kongresin e Peste te PKJ dhe shprehen kundra Rezolucjonit te Byros Informative, ne te cilen Partija e jone, Komiteti Qendruer dhe shoku Tito jane akuzue se nuk ndjekin po'liTen e drejte te jashtme dhe te mbrendeshme. Ne telegramet dhe letrat e tyne, drejtur KQ te PKJ, antaret e Partis te Krahines s'one shprehin besimin e tyne te pakufishem ne shokun Tito dhe KQ dhe kerkojne qe te ndalen akuzat kundra Partis s'one.

MITROVICE

Ne Mitrovice konferenca asht mbajte ne sallen kulturore te shtepis se kultures me kater te ketij muejit. Ne konference kane asistue 226 delegate nga organizatat themelore te puntoree te Trepçes dhe qytetit te Mitrovices, nga te cilet 00 shqiptare. Ne konference kane asistue edhe perfaqesuesat e organizatave masovike si dhe delegati i Komitetit Krahinuer, shoku Ali Shukrija. Konferencen e hapi nji nga antaret ma te vjeter te Partis, Millovan Vezmar, e ne kryesin e punes hyen shoket Lakiq Simunoviq, Rasim Çerkezi, suimues Osman Murati, Koviljaka Tojaga dhe Millovan Vezmar.

Para se me kalue ne rendin e dites ,fjalen e muer shoku Ali Shukrija, antar i Komitetit Krahinuer, i cili e vueni ne dukje randesin e mbajtjes se konferences ne ditet kur rreth vendit t'one perhapen fjale se na nuk po e ndertojme socjalizmin. Konferenca e jonë do t'i paraqes menyrën e punes s'uej dhe do t'i jape Kongresit te Peste materjal qe te mundet ma lehte me i shenjue perspektivat e zhvillimit t'one te matutjeshem. Mandej ceku zhvillimin historik t'organizates se Partis ne vend dhe pjesemarrjen e saje ne lufte si para luftes ashtu dhe gjate luftes nacjonal-çlirimtare. Mbas shlirimit tha ai, Partija e jone ka krijue njerëz e ri, siç jane Shemsi Sulejmani dhe Osman Murati, te cilet tregojne se njerzit e krijuem ne kushtet t'ona jane t'afte me e mbajte peshen e ndertimit te socjalizmit. Shpifjet kundra Komitetit t'one Qendruer dhe Partis s'one jane fryt i infoormimit shum te gabueshem mbi ne. Prandaj ngrihet kaq nalte zani i secilit qytetar te ndershem te Vendit t'one. Bashkimi i rradhve t'ona rreth shokut Tito asht per në nji motto luftarake, perfundoj shoku Shukrija.

Mandej Lakiq Simonoviq, sekretari i Komitetit te vendit dha referatin politik. Ai vueni ne dukje rrugen historike te Partis s'one neper luften per barazimin nacional dhe te drejten socjale mbas luftes se pare botnore, e mandej neper luften kundra regjimeve diktatorjale dhe te kolones se peste. Aj vueni ne dukje edhe luften e Partis per pastertimin e saje ideologjike. Shoku Simonoviq nenvizoi se Partis s'one i kane mungue udheheqesat e tipit leninist, te cilet t'ishin t'afte me e udheheqe Partin dhe masat popullore ne luften per socjalizem, per deri n'ardhjen e shokut Tito ne krye te Partis ne vjetin 1937, i cili e ka udheheqe Partin t'one ne rrugen e luftes revolucjonare dhe ka bashkue masat t'ona rreth flamurit te saje. Mandej shoku Simonoviq foli mbi fitoret madhështore te Partis s'one dhe popujve t'one ne kohen e luftes dhe mbas luftes, kur popujt t'one, ne krye me shokun Tito, me vepra, ndertojne socjalizmin. Mandej shoku Simonoviq ceku zhvillimin e organizates se vendit te Partis, sukseset dhe mossukseset e saja te deritashme. Veçanerisht e nenvizoi leshimin qe s'asht ba perpjekje e duhun per ngritjen dhe pranimin ne Parti te shokve shqiptare, gja e cila asht eliminue ne kohen e fundit. Sot organizata e partis numron 1925 antare, nga te cilet 571 jane shqiptare. Shoku Simonoviq ne fund, foli mbi detyrat e organizates se Partis ne Mitrovice ne fushen ideo-politike, prodhimin, zgjedhjen e çashtjeve komunale, çeshtjes se Huas popullore etj.

Ne diskusjon muer pjese nji numer i madh delegatesh, nder te cilet edhe sulmuesi i njoftun Shemsi Sulejmani, i cili çfaqi huntusin e tij qe gjindet ndermjet njerzve ma te mire. Ai tha se suksesi ne pune mund t'arrihet nga gjithkush qe ka vullnet per pune e se komunistat duhet te jene si gjithmone — shembull. Fjalet e tija, delegatet i pershendeten me entuzjazem te madh.

Mbas mbarimit te diskusionit dhe fjales se fundit te shokut Ali Shukris, filloi votimi per delegatet per Kongresin e Peste. Me vota te mshefta u-zgjodhen 6 delegate: Ali Shukrija, Laliq Simonoviq, Misho Miçkoviq, Osman Murati, Jashar Ramo dhe Borivoje Tomiq.

Ne fund te konferences iu dergue telegram pershendetes KQ te PKJ:

Komitetit Qendruer te PKJ

Beograd

Shoke te dashtun,

Ne delegatet e konferences se qytetit zgjodhem sot delegatet per Kongresin e Peste te PKJ. Jemi thellesisht koshiente per randesin qe ka Kongresi i Peste per Partin dhe popujt t'one dhe te gatshem me e prite me rezultate ma te mira ne pune ne ndertimin e Vendit t'one.

Kongresi i Peste i PKJ do te shtroje detyre te reja para Partis s'one. Premtojme se do te bajme gjithshka qe te kryhen plotesisht.

Nuk mundemi mos me e shprehe mosknaqesin per ofendimin e thelle i cili i asht ba Komitetit t'one Qendruer dhe Partis s'one me rezolucjonin e Byros Informative. Nuk mund te kuptojme se si Partis s'one mund t'i mohohet rruga ne te cilen ecim ne socjalizem, gja per te cilen na jemi binde qysh ma perpara.

Veçanerisht na ofendon akuza se udheheqsija e jone ndjeke nji politike armiqsore kundrejt Bashkimit Sovjetik dhe KQ te BRSS. Na e dijme se Tito dhe Partija na kane edukue gjithmone me shembujt e Partis Bolshevike, me frymen e dashunis ndaj vendit te pare socjalist ne bote. Na do t'a zhvillojme e do t'a fillojme edhe ma fort dashunin vllaznore ndaj Bashkimit Sovjetik, Partis se tij Bolshevike dhe shokut Stalin.

Akuzat e randa dhe te padrejta te Byros Informative i hedhin poshte si te padrejta dhe te pathemelta, sepse mija shembuj na kane binde ne drejtesin e udheheqesis dhe besnikrin e saje ndaj çashtjes se socjalizmit. Neve na çudite thirrja e Byros Informative qe i fton antaret e Partis s'one kundra udheheqesis s'one. Na, delegatet e konferences se qytetit t'organizatave te Partis se kolektivitetit te „Trepçes" dhe te qytetit te Mitrovices, jo vetem se s'e pranojme kte ftese, por deklarojme se do t'i shtrengojme edhe ma fort rradhet t'ona rreth Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito. Na jemi te vendosun ngultazi qe t'a vazhdojme luften e matutjeshme per ndertimin dhe me punen t'one te vertetojme se akuzat kundra KQ jane te padrejta e te bazueme n'informatat shpifse t'armiqve te Partis s'one. Komiteti i yne Qendruer, me shokun Tito ne krye, deri tash na ka udheheqe prej fitores ne fitore edhe ne t'ardhmen do te na udheheqe drejt fitores se plote te socjalizmit.

Rrnofte Kongresi i Peste i PKJ!
Rrnofte KQ i PKJ!
Rrnofte Sekretari gjeneral i PKJ, shoku Tito!

Delegatet e konferences se qytetit Mitrovice

PRISHTINE

Ne Prishtine u-mbajt konferenca e pare e Partis per qytetin e Prishtines. Ne konference asht shqyrtue puna e deritashme e organizates se Partis ne Prishtine dhe jane zgjedhe delegatet per Kongresin e Peste te PKJ.

Sekretari politik i komitetit te vendit, shoku Stanoje Aksiq, paraqiti referatin. Mbasi e ceku zhvillimin historik te partis s'one dhe rolin e shokut Tito ne krijimin e partis monolite, e cila i ka udheheqe drejte popujt t'one neper ditet e lavdishme te luftes nacjonal-çlirimtare dhe ne periudhen e mbas luftes, shoku Aksiq foli mbi punen e organizates se partis ne Prishtine ç'prej kapitulimit te Jugosllavis e deri tashti.

„Mbas kapitullimit te Jugosllavis se vjeter,-tha ai- kane qene vetem disa antar te partis. Ata kane punue n'organizimin e levizjes nacjonal-çlirimtare. Mbas sulmimit te Gjermanis ne Bashkimin Sovjetik kane shtype lajme, proklamata dhe materjalin tjeter agitacjono-propagandistik, tue i thirre patriotet per pjesmarrjen ne levizjen nacjonal-çlirimtare. Ne mbarim te vitit 1941 numri i antarve te Partis asht ngrijte ne 20 e numri i antarve te SKOJ-it ne 60. Ata kane mbledhe qark Partis nji rreth te gjane simpathizuesish. Atehere Partija luftonte per zgjimin e masave shqiptare, megjithse ktu ka pase vetem tre antar te PKJ Shqiptare. Ne mbarim te vitit 1942 kane qene 50 antar te partis dhe 150 antar te SKOJ-it. N'ate kohe partija ka likuidue frakcjonin sindikalist, te cilin e ka udheheqe Ljubomir Miliq. Ne gjysmen e vitit 1943 asht formue komiteti i rrethit te PKJ dhe komiteti i vendit per Prishtine, si dhe komiteti i vendit te SKOJ-it. N'udheheqesi kane qene ne shumice intelektualet, çka ka sjelle ma vone dobsina ne punen e partis. Ne fillim te vitit 1944 asht thye frakcjoni i dyte, te cilin e kane krijue Ljubomir Petkoviq, Dragi Janiqijeviq dhe Dragi Jovanoviq, te cilet ambicjen e tyne te teperme qe te vije ne vendet udheheqese e kane maskue me fjalet se gjoja duen qe edhe popujt te vijne n'udheheqje dhe i kane shpalle greve partis.

Ne qershuer te vitit 1944 asht ba zbulimi i organizates se Partis, per shkak te qendrimit te dobet te komitetit te rrethit dhe te vendit. Gestapoja e hetoi dhe e shkatrroi organizaten e partis dhe te SKOJ-it ne Prishtine. Deri ne çlirim nuk ka ekzistue asnji organizate e partis. Ne mbarim te vitit 1944 kane qene vetem 10 deri 12 antar partije ne Prishtine.

Mbas çlirimit partija asht ngrite dhe numron afro 900 antar te lidhun ne 70 qelije, 58 kandidate dhe 970 antar te SKOJ-it. Ne Parti gjinden edhe 306 shoke shqiptare.

Mbassi theksoi sukseset ne punen politike te PKJ ne territorin e Prishtines, shoku Aksiq permendi disa te meta t'organizates se Partis, tue nenvizue punen e dobet ne ndihmen e qelijave te partis SKOJ-it dhe organizatave te tjera masovike e veçanrisht Frontit populuer dhe Fag-ut.

„Ne konferencat e Frontit populluer, tha Aksiqi, marrin pjese 40 deri 50% t'antarve te Frontit. 20% te frontistave marrin pjese ne njisina puntore e thenkat i vizitojne vetem 10% te qytetarve.

Nji nga leshimet ma te mdhaja t'organizatave te partis qendron ne faktin se komiteti i vendit nuk e ka zotnue diplomatiken ekonomike te punes, dhe qe qelijat e partis neper sipermarrjet nuk interesohen mjaft per realizimin dhe tejkalimin e planeve t'atyne. Ne qelijet prane sipermarrjeve lokale nuk studjohen menyret e luftes per paksimin e çmimeve, per furnizimin ma te mire dhe ma te shpejte te qytetarve."

Mbas referatit te shokut Stanoje Aksiq u-zhvillue diskusjoni. Ne diskusion u-shpreh solidarizimi me qendrimin e KQ te PKJ ne lidhje me rezolucjonin e Byros Informative.

Ne fund sekretari i Komitetit Krahinuer te PKS per Kosmet, Gjoko Pajkoviq nenvizoi se ne konferenca nuk jane shqyrtue thelle çashtjet e ndertimit t'ekonomis komunale.

Mandej u-kalue ne piken e dyte te rendit te dites, ne zgjedhjen e delegatve per Kongresin e Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis.

Per Kongresin e Peste te PKJ u-zgjodhen:

Gjoko Pajkoviq simpathizues i levizjes perparimtare ç'prej vitit 1933, antar i PKJ prej vitit 1935; ne vitin 1936 asht arrestue dhe gjykue me tri vjet burgim; antar i Komitetit te Vendit ne Berane ç'prej vitit 1939, antar i shtabit ne Berane ç'prej vitit 1941, mandej antar e pastaj sekretar politik i Komitetit te qarkut per Berane, Andrijevice dhe Kolashin; nji nga udheheqsat e luftes nacional-çlirimtare ne Vasojeviq gjate gjithe kohes se luftes; mbas çlirimit antar i PK per Mal te Zi, e prej vitit 1945 sekretar politik i Komitetit Krahinuer te Partis Komuniste te Serbis per Kosmet; deputet populluer n'asamblen e perbashket, antar i KQ te PKS.

Aksiq Stanoje, simpathizues i levizjes perparimtare qysh prej kohes se para luftes; antar i PKJ ç'prej nandorit te 1941, pjesmarres aktiv ne luften nacional-çlirimtare, mbajtjes i medaljes se 1941-shit. Ne fund te vitit 1943, antar i Komitetit Krahinuer te SKOJ-it, ma vone sekretar organizativ i Komitetit te vendit ne Prishtine, e prej vitit 1946 sekretar politik i Komitetit te vendit Prishtine.

Ashim Mustafa, antar i PKJ ç'prej vitit 1945, mandej antar i Komitetit te rrethit ne Prishtine, e tash sekretar organizativ i Komitetit te vendit.

Sherafedin Sulejmani, antar partije ç'prej vitit 1946, e tash sekretar'i Komitetit te vendit te SKOJ-it.

Rako Radulloviq, simpathizues i partis qysh para lufte, antar i partis ç'prej vitit 1946, e tash sekretar'i Komitetit te vendit per Kotor, e ma vone antari i Komitetit te qarkut per Kotor, mandej udheheqsi i Komiteti te qarkut te PKJ ne Kotor, instruktor i Komiteti Krahinuer per Kosmet prej vitit 1945.

Nga konferenca e tyne, delegatet e Partis te rrethit te Prizrenit ia kane dergue KQ te PKJ kete telegram

Komitetit Qendruer te PKJ

BEOGRAD

Nga konferenca e trete e Partis per rrethin e Prizrenit pershendesim Komitetin t'one Qendruer dhe shokun Tito.

Jugosllavija kapitaliste dhe okupata fashiste na kane lane nji trashigim te veshtire, te cilin organizata e jone e Partis me punen e vetmohueshme e ka eliminue tue forcue vllaznimin dhe bashkimin e shqiptarve, serbve dhe malazezve; ajo i ka mesue masat me e dashte Jugosllavin, popujt vllazen te shteteve te demokracis se vertete dhe te gjithe popujt e botes, te cilet luftojne kundra imperjalizmit, e veçanerisht, me i dashte popujt heroik dhe vllazen te Bashkimit Sovjetik dhe Stalinin e Madh.

Me zhdukjen e marredhanjeve feudale dhe me masat e tjera ne katund, na jemi lidhe fort me katundarine e vorfen dhe te mesme.

Ne rrethin t'one, masat shqiptare dhe serbe kane qene shum te mbrapambetuna kulturalisht. Me anen e hapjes se shkollave ne çdo katund, me luften e vendosun per likuidimin e analfabetizmit dhe me punen e gjithaneshme per ngritjen e nivelit ideo — kultural, kemi arrijte rezultate te dukshme drejt likuidimit te kesej mbrapambetjeje. Te gjithe keto dhe te tjerat kemi arrijte ne saje te linjes se drejte te Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito.

Tue e shqyrtue punen e organizates s'one te Partis e tue ia kushtue kujdesin e plote kritikes se te metave dhe leshimeve, siç na ka mesue Partija e jone, na tash i presim me vullnet edhe ma te madh detyrat qe do t'i shtroje, para nesh Kongresi i Peste dhe i premtojme Komitetit Quendruer se do t'i kryejme denjesisht. Rezolucjoni i Byros Informative mbi gjendjen ne Partin t'one asht shpifje ma e rande dhe nji padrejtesi historike, e cila i asht ba Partis s'one dhe popujve t'one.

Ne Rezolucjonin e Byros Informative na thrrasin me e hjeke Komitetin t'one Qendruer, si jo revolucjonar, si jo internacjonal.

Ata qe kane qene jo revolucjonare dhe jo internacjonale i kemi spastrue nga rradhet t'ona, d.m.sh. trathtaret e Partis s'one dhe popujve t'one-Zhujoviq dhe Hebrang. Thirrja e tille na fyen e njikohesisht na lidhe me nji dashtuni edhe ma te forte me Komitetin t'one Qendruer dhe shokun Tito, te cilet e kane mbajte nalte flamurin e internacjonalizmit proletar.

Sado te randa qe jane akuzat e PK (b) te BRSS, dashunija e jone ndaj saje dhe Bashkimit Sovjetik nuk paksohet. Na edhe tash e mbrapa e duem PK (b) te BRSS dhe solidarsin me partit e tjera Komuniste simotra. Nen udheheqjen t'uej, tue punue edhe ma teper, do t'a konfirmojme gjithnji linjen e drejte te Partis s'one dhe Komitetit t'one Qendruer.

Rrnofte Partija e jone heroike Komuniste e Jugosllavis!

Rrnofte Komiteti i jone Qendruer me shokun Tito ne krye!

Rrnofte Kongresi i Peste i Partis s'one!

Ne katundet Krajishte dhe Godanc po ndertohen shkolla fillore

Tue iu pergjegje akuzave te padrejta qe i jane ba Komitetit t'one Qendruer dhe tue u-perpjekë me mbrrijte rezultate sa ma te mdhaja ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, antaret e Frontit populluer te Krajishtes dhe te Godancit jane tue e shpejtesue punen per ndertimin e godinave te shkollave fillore ne katundet e tyne.

Ndertimi i ketyne dy shkollave ka fillue para disa ditesh me vet inisjativen e frontistave. Populli i Godancit ka marre persiper, qe tue marre pjese aktive ne punen vullnetare per ndertimin e kesaj shkolle t'a kurseje shumen prej 200,000 dinaresh.

PRIZREN:

Frontistat e rrethit te Prizrenit luftojne per kryemjen e obligimeve te dhamuna ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Vetem ne muejin qershuer ne ndertimin e rruges „9 maj" jane dhane ma se 4.400 ore pune ne njerez dhe 2.100 ne kafshe barteve.

Per kete rruge frontistat kane sjelle 100 kubike gure. Dy çeta te frontistave kane punue ne fidanishten shteinore, ndersa dy te tjera kane punue ne pastrimin e pemishteve. Ne rritjen e krymbave te mendafshit, antaret e FAO kane dhane ne muejin qershuer ma se 4.500 ore pune.

Regjistrimi i Huas popullore - prove e gjalle ndergjegjeje dhe patriotizmi

Rezultatet e deritashme te mbrrijtuna ne regjistrimin e Huas tregojne se Huaja pare popullore e Planit t'one pesvjeçar ka marre nji karakter te pergjitheshem popullor dhe as'it ba prove e gjalle per ndergjegjen e nalte patriotike te turmave te gjana punuese. Edhe kesaj here populli i jone, i prime prej avangardes se vet - klases punetore, ka vrapue me e shprehe dashunin dhe besnikin e vet ndaj atdheut, ndaj pushtetit popullor, ndaj Partis dhe shokut Tito. Kjo shifet nga fakti se ne regjistrimin e Huas popullore po marrin pjese turmat ma te gjana punuese — puntoret, katundaret, inteligjenca popullore, zejtaret dhe qytetaret tjere. Ne regjistrimin e Huas popullore po prine klasa puntore. Te gjithe kolektivat punuese te Krahines s'one e kane regjistrue Huan popullore qysh ne ditet e para dhe shumica e tyne i kane shkue perteri shumat qe i kishin regjistrue ma pare. Regjistrimi i Huas popullore gjithashtu u ka dhane mundesi me i shprehe ndjenjat patriotike te gjithe atyne, te cilet, ne luften Nacionalçlirimtare e mandej edhe ne lufte per ndertimin socjalist ne Vendin t'one kane dhane gjithshka prej vedit, ne menyre qe atdheu i jone te zhvillohet dhe te lulezoje. Si pjesmarresat e luftes Nacionalçlirimtare ashtu dhe invalidet e luftes e prindet e luftetareve te rane, kane qene te paret ne regjistrimin e Huas.

Ndjenjat e veta patriotike i ka shprehe edhe katundarija e jone punuese, veçanerisht, n'ato vende ku asht shjarue randesia e regjistrimit te Huas, qellimi dhe kushtet e saje, si edhe n'ato vende ku asht organizue mire e gjithe puna teknike.

Ne ket menyre, turmat t'ona punuese u kane dhane pergjegjen e duhun te gjitha akuzave dhe shpifjeve kundra Partis dhe udheheqesis s'one dhe kane tregue bindjen e tyne te patundeshme ne vijen e drejte te Partis s'one e te Komitetit Qendruer te PKJ, me shokun Tito ne krye.

Me gjithse ne Krahinen t'one jane korre perfundime te mira dhe deri ne mbramjen e dates 9 korrik jane regjistrue 109.576.000 dinare, simbas rezultateve jo te plota qe i disponon Komisjoni Krahinuer per regjistrimin e Huas, prap se prap ne disa vende jane konstatue disa dobesina organizative dhe teknike, te cilat e pengojne zhvillimin edhe ma te suksesshem te regjistrimit te Huas. Kjo gja konstatohet edhe nga rezultatet e deritashme. N'ato vende ku organizatat popullore dhe komisjonet per regjistrimin e Huas e kane skjarue gjithaneshmenisht randesin ekonomike dhe politike te regjistrimit te Huas, jane korre rezultate te mira si p.sh. ne rrethin e Mitrovices ku jane regjistrue 11.985.000 dinare, ne rrethin e Gjakoves, i cili ne ditet e para kishte ngele mjaft mbrapa, jane regjistrue, mbrenda pak ditve, 11.126.000 dinare, mandej ne rrethin e Rahovecit, Pejes, Ferizajt etj. Kurse ne rrethin e Prishtines, Podujeves dhe te Kamenices puna asht tue u-zhvillue ma me ngadalesi dhe rezultatet jane ma te vogla.

Ne lidhje me regjistrimin e Huas asht konstatue dhe nji e mete tjeter e kjo asht mos-dergimi i lajmeve ne rregull. Per shembull me daten 9 te ketij muejit nuk jane dergue shenimet perkatese per 11 keshilla vendesh te rrethit te Rahovecit, per nga 9 keshilla vendesh te rretheve: Gjur. koce, Gilan, e Kamenice si dhe per 12 keshilla vendesh te rrethit te Podujeves.

Tue qene se regjistrimi i Huas asht tue u-ba ne kohen e punimeve te mdhaja bujqesore si k. t. ne kohen e korrjes, shirjes, mbjelljes per se dyti dhe mbjelljes se misrave, kositjes se livadheve etj. organizatat popullore dhe komisjonet per regjistrimin e Huas duhet te perpiqen me e pershtate kohen e regjistrimit me kohen e punes se turmave te gjana, ne menyre qe ato te mos humbin kohen, te mos detyrohen me prite prane vendeve te regjistrimit etj.

Tue i evitue keto te meta, tue e shtue aktivitetin e punes agjituese dhe tue e permiresue punen organizative e teknike do te shpejtohet regjistrimi i Huas, qe ka per qellim me e shpejtue realizimin e Planit t'one Pesvjeçar, perparimin e bujqesis, ngritjen e nivelit jetesor, material e kultural te popullit ne qytet e katund, krijimin e nji jete ma te mire e ma te lumtun, forcimin e gjithaneshem t'atdheut t'one socialist.

Regjistrimit i Huas popullore ne rrethin e Istokut

Regjistrimi i Huas popullore asht tue vazhdue me sukses ne mbare teritorin e keshillit popullor te rrethit t'Istokut Per shtate ditet e para jane regjistrue 6.362.000 dinare. Ne regjistrimin e Huas popullore jane dallue deri tash keshillat popullore te vendeve Zaleç, i cili ka regjistrue 881000 dinare dhe Shkupel, i cili ka regjistrue 880.000 dinare.

Rezultate ma te dobta jane mbrrijte ne keshillat e vendeve Kline dhe Cerkolez. Ne te parin jane regjistrue 144.000 dinare dhe ne te dytin 150.000 dinare. Siç duket ne keto dy vende nuk asht shjarue mire Dekret-ligji mbi Huan popullore dhe nuk jane ba punet pregaditse ashtu siç duhet,prandaj, nuk jane mbrrijte rezultatet e dshirueme' mbasi keto dy vende jane mjaft te pasuna, sidomos Klina.

Dega sindikale e zejtarve asht dallue nga te gjitha deget tjera. Kjo ka regjistrue 65.000 dinare. Dega sindikale e arsimtareve nuk ka fillue ende me regjistrimin e Huas popullore.

Katundi i vogel dhe i robeqet Serbobran ka regjistrue 59.000 dinare.

Asht per t'u vue ne dukje se disa komisione te vendeve nuk i dergojne lajmet me kohe rreth regjistrimit te Huas, e sidomos komisioni i qendres Gjurakovcit.

Mbas keshillit popullor te vendit Vitomirice jane korre rezultate te mira edhe ne Keshillin e vendit Stupe, ku ne regjistrue 692.250 dinare.

Fahrije Drejta nga Vuçiterna ka regjistrue 20.000 dinare

Fahrije Drejta nga Vuçitrna, e cila para nji vjeti e ka hudhe perdet çarshafin dhe asht çlirue per gjithmone nga prangat e zakoneve prapanike, po sa ka ndigjue per Dekret - ligjin mbi Huan popullore, mezi ka prite qe te filloje regjistrimi dhe t'i epet mundesija qe edhe ajo te kontribuoje dhe te kryeje kete detyre nderi ndaj atdheut t'one socialist. Kjo nder ma te paret ka premtue 20.000 dinare. Ajo, me kete rast ka thane: „Un nuk kam pare te gateshme, por do t'i shes nji pale dimi, keshtu qe edhe une t'a ndihmoj plotesimin e Planit pesvjeçar dhe perparimin e Vendit t'one".

Hapja e kurseve pedagogjike ne Krahinen t'one

Ne fillim te ketij muaji u-hapen dy kurse pedagogjike — ne Prishtine e Gjakove. Qe ne ditet e para u-paraqiten kandidatet — rreth 300 ne Prishtine dhe 100 te tjere ne Gjakove — t'ardhun prej te gjitha aneve te Krahines s'one.

Me anen e ketyne kurseve do te shtohet dhe te permirsohet kualiteti i punes se mesuesve t'one, do te zgjanohet edhe ma rrjeta e shkollave t'ona ne Krahine dhe mesuesit do te kenë aftesi ma te madhe per te kontribue sa ma shum, jo vetem ne mesimin e edukimin e femijve, por edhe te masave te gjana popullore.

Ne sallen e gjimnazit te Prishtines para pak ditesh u ba inagurimi i kursit pedagogjik, ku pervec kandidatve muerren pjese perfaqesues i Drejtorait arsimor dhe mesim-dhanesit.

I pari e muer fjalen drejtori i kursit, shoku Nebil Dino, i cili vuni ne dukje te drejtat e barabarta qe gezojne popujt t'one ne Jugosllavi e te t'udhehequn prej Partis se ken Komuniste, me shokun Tito ne krye. Ai i theksoi edhe fjalet e Gjilasit „qe kaliura e çdo nacioni ne Jugosllavi duhet te zhvillohet me fryme socjaliste, tue ndikue ne dobin e gjithanshme te popujve t'one".

Mandej e muer fjalen perfaqesuesi i Drejtoratit shoku Mehmet Gjevori, i cili theksoi kujdesin dhe interesimin e madh qe ka pushteti i jone popullor per ngritjen e kuadrave arsimore tue u dhane te gjitha mundesinat dhe ndihmen maksimale qe ata te pajisen me dije dhe edukate te shendoshe ne frymen socjaliste.

Mbas ketij e muer fjalen shoku Xheladin Hana, i cili theksoi se edhe vet sistemi i jone mesimuer — edukativ, qe frymzohet nga shkenca marksiste-leniniste, asht prove e kjarte e linjes se drejte te PKJ dhe Komitetit te saje Qendruer me shokun Tito ne krye, linjes se luftes konsekuente per likuidimin e mbeturinave te kapitalizmit dhe ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one, linjes se mardhanjeve dhe bashkepunimit vllazenuer me blokun anti-imperjalist demokratik, me BRSS ne krye, kundra kampit imperjalist antidemokratik, me imperjalizmin amerikan ne krye.

Nga situata nderkombtare

Politika e Bashkimit Sovjetik ne Gjermani asht n'interes te paqes dhe demokracis ne botë

Copitimi Gjermanis dhe inkuadrimi i pjeses se saje prendimore ne rradhen e vendeve te planit Marshall, te nenshtrueme tutoris amerikane, asht pregatite kohet para Konferences se Londres, e „me zbatimin e reformes separatiste valutare ne zonat prendimore t'okupacjonit - siç e ka skjarue kte pushteti ushtarak sovjetik - asht shkele uniteti i qarkullimit te pares dhe i asht dhane grusht bashkimit te Gjermanis, e ne ket menyre asht krye ploteshisht copitimi i Vendit".

Asht e dijtun se perfaqesuesat e Bashkimit Sovjetik ne Keshillin e ministrave te punve te jashtme dhe ne Keshillin kontrollues aleat per Gjermanin, tue luftue per zbatimin konsequent te vendimeve te Potsdamit mbi krijimin e shtetit te ri, unik, demokratik gjerman, jane angazhue edhe per zbatimin e reformes unike te pares ne mbare Gjermanin. Fuqit prendimore e kane refuzue vazhdimisht shqyrtimin e propozimeve sovjetike dhe ma ne fund shpallen reformen separatiste valutare ne zonat e tyne. Kuptohet se nen keto kushte asht ba i domosdoshem edhe ndrrimi i valutave te vjetra ne Gjermanin lindore, si e si te pengohet depertimi i pares se vjeter nga prendimi, gja qe do te provokonte kaosin ekonomik ne zonen sovjetike t'okupacjonit.

N' urdhnin e tij mbi zbatimin e reformes valutare ne zonen sovjetike, te cilin e transmetoi agjensija „Tass", marshali Sokolovski ka thane se situata e krijueme ne zonat prendimore „asht rrezik serjoz per rindertimin e zhvillimin normal t'ekonomis paqesore te mbare Gjermanis. Pushteti ushtarak sovjetik, tue u anthe ne ndihme kerkesave t'opinjonit demokratik gjerman, asht i detyruem me marre masa te paevitueshme mprojtese per mprojtjen e interesave te populsis gjermane dhe te zones sovjetike t'okupacjonit ne teritorin e Berlinit te madh. Prandaj e ka pranue propozimin e komisjonit ekonomik gjerman per zbatimin e reformes valutare ne zonen sovjetike t' okupacjonit ne Gjermani".

Stabilizimi ekonomik ne zonen sovjetike nuk u ka leverdise imperjalistave amerikane, e bashk me keta as Britanis se Madhe e Frances. Ata kane deshte me e dizorganizue ekonomin e saje, tue u-perpjeke qe per kete qellim t'i çrytezojne zonat e tyne t'okupacjonit ne Berlin.

Kryeqyteti i Gjermanis, Berlini, gjindet ne zemren e zones sovjetike dhe ekonomija e tij asht e lidhun me ket zone. Shkeputja e Berlinit prej Gjermania Lindore, me futjen e t'ashtuquejtunes „marke prendimore" si valute ne pjesen amerikane — britanike — franceze te qytetit, do t'a rrezikonte jeten ekonomike te Berlinit dhe banoret e tij, do t'i shkeputte pjeset prendimore te qytetit prej rrethit dhe do t'a turbullonte te gjithe ekonomija e Gjermanis lindore. Prandaj pushteti ushtarak sovjetik ka vendose qe, njikohesisht me ndrrimin e valutes se vjeter ne Gjermanin lindore, te zbatoje reformen e pares edhe ne Berlinin e Madh.

„Inisjatoret e reformes separatiste te valutes ne Gjermanin prendimore — thuhet ne proklamaten e marshalit Sokollovski te cilen e transmetoi me kete rast agjensija „Tass" — perpiqen me e shue ekonomin e zones sovjetike te Berlinit, me e çrytezue qeverimin katersh ne qytet per dizorganizimin e qarkullimit te pares dhe me e asgjasue zhvillimin ekonomik si te krahines se Berlinit te Madh ashtu edhe te mbare zones sovjetike t'okupimit ne Gjermani. Tue e ndalue qerkullimin e valutes se re te zonave prendimore ne Berlin, pushteti ushtarak sovjetik mpron vetem interesat e populsis gjermane te zones sovjetike t'okupimit dhe te krahines se Berlinit". Pushtetet prendimore t'okupimit, me gjithse edhe vet te bindun se kjo mase sovjetike asht e vetmja logjike dhe e mundeshme, bash per kete arsye u çuen kundra perdorimit te markes se re te Gjermanis lindore ne zonat e tyne te Berlinit, per t'a pranue mbasandej e per t'a qite prap, etj. Qellimi i tyne ka qene qe, po qe se si e mundeshme, t'a pengojne stabilizimin e ekonomis ne zonen sovjetike dhe te shkaktojne kaosin ekonomik ne dobi t'imperjalistave amerikane dhe planeve te tyne, ne dam te popullit.

Pushteti Sovjetik, per t'a pengue kontrabanden e valutes nga Gjermanija prendimore ne zonen sovjetike te okupimit, e kane kufizue komunikacjonin ndermjet Gjermanis lindore dhe zonave prendimore, e gjithashtu edhe me sektorin amerikan, britanik e frances te Berlinit. Byroja informative e pushtetit ushtarak sovjetik ka komunikue se „ne lidhje me reformen separatiste valutare ne zonat prendimore t'okupimit te Gjermanis, pushteti ushtarak sovjetik ka qene i detyruem me marre nji seri masash per mprojtjen e interesave te populsis dhe t'ekonomis se zones sovjetike". Nxitesat e luftes te kampit imperjalist me njiherë filluen me bertitje mbi situaten „kritike" dhe „mundesinat e luftes", tue kumtue se shpetimi vjen prej „hyjnise krishtane" dhe tue kercnue me „hapa te vendosun", e perfaqesuesit e SH.B.A., Anglis dhe Frances ne Berlin kane fillue te furnizohen me ane t'aeroplanave dhe t'i kalojne thaset plote „marka te reja prendimore" per ndrrimin e pares ne sektoret e tyne. Por, me gjithse ne fillim kane pohue se valutat e zones sovjetike nuk do te vlejne ne zonat prendimore te Berlinit, pushtetet amerikane, britanike dhe franceze qene te detyrueme t'a terhjekin ket vendim dhe t'a lejojne perdorimin e tyne. Nga ana tjeter, markat prendimore, te kalueme ne sektoret prendimore te Berlinit, nuk mund te vlejne as nuk vlejne ne zonen sovjetike. Keshtu, akti i pare i „drames se Berlinit" te cilin e çfyteqzuen ne prendim per potere te madhe shterpe mbi luften, perfundoi me mossuksesin e imperjalistave.

Gjestet e mjaneshme te fuqive prendimore, copitimi i Gjermanis dhe reforma separatiste ne zonat prendimore perfaqesojne shkeljen arbitrare te vendimeve te Jaltes e Potsdamit mbi krijimin e Gjermanis unike demokratike, e prandaj edhe akt te ri te shkeljes se bashkepunimit nderkombtar. Keto gjeste jane njikohesisht edhe katastrofale per populli gjerman. Pasojat e reformes valutare ne prendim te Gjermanis, te kryeme ne dobi te spekulantave dhe kapitalistave, ne dobi te kartelave dhe magnateve industrijale per rindertimin e potencjalit luftarak t'industrise, qysh tash kane fillue te çlaqen: puntoret e Gjermanis prendimore nuk jane ma ne gjendje qe me rrogat e tyne t'i plotesojne pagesat per banese dhe ushqim, e ne fabrika ka fillue leshimi masovik i puntorve prej punes. Perkundrazi reforma e valutes ne zonen sovjetike dhe ne Berlin „kujdeset per interesat e populli punues, kujdeset mbi parimet e drejtesis socjale dhe mbi nevojat e rindertimit dhe zhvillimit sa ma te shpejte t'ekonomis paqesore te Gjermanis. Kjo do te zbatohet me humbjet ma te vogla per njerzit e punes. Pesha ma e madhe e humbjeve do te bie mbi personat qe gjate luftes jane pasunue me ane te spekulimit dhe mahinacjoneve antiligjore ne tregun e zi" (Tass). Prandaj reforma e valutes ne zonen sovjetike, me gjithse imperjalistat me aksjonin ne Berlin jane perpjeke me e pengue zbatimin e saje, perfaqeson nji hap te madh perpara per konsolidimin e ekonomis ne zonen lindore.

Ne sesjonin e udheheqsis se partis unike socjaliste, e cila ka hartue projektin e planit dyvjeçar per zonen sovjetike, asht konstatue se zbatimi i planit te rindertimit ekonomik „do t'i tregoje mbare populit gjerman . . . se perparimi ekonomik i realizuem ne zonen sovjetike asht ma i fort ne krahasim me anashtu kapitaliste ekonomike ne zonen prendimore te Gjermanis dhe duhet te sherbeje si shembull i gjalle per mbare Gjermanin".

Planin dyvjeçar i zones sovjetike, cili asht ne studim e siper, dhe zbatimi konsequent i reformave d mokratike ne Gjermanin lindore, tregojne se Qendrimi i Bashkimit Sovjetik ndaj Gjermanis asht n'interes te paqes, d. m. th. n'interes te gjithe popujve dhe te vet popullit gjerman, ndersa forcat tjera t'okupacjonit e shkelin edhe bashkepunimin nderkombtar mbi te cilin duhet te mbeshtetet paqa edhe marreveshtjet qe i kane nenshkrue. Forcat demokratike, e ne rend te pare Bashkimi Sovjetik, nuk do te lejojne qe te realizohet politika imperjaliste ndaj Gjermanis, shprehje e te cilës asht edhe qendrimi i fuqive prendimore ne Berlin. Ato do te luftojne qe Gjermanija te bahet me te vertete vend paqedashes, unik e demokratik, i cili nuk do t'u kercnohet popujve tjere.

Ne rrethin e Liplanit nuk asht plotsue ende plani i kontraktimit te drithnave te bardhe

Rethi i Liplanit asht nji nder rrethet ma te pasuna me drithna ne Krahinen t'one, e sidomos sivjet korrja asht shum e mire. Me gjithe kete plani i kontraktimit te drithnave te bardhe asht realizue vetem me 60 per qind.

Ne keto dite, asht krye te çmuemit e prodhimit te drithnave te bardhe. Komisjoni perkates i rrethit ka hase ne veshtiresina, mbassi elementat kulakjane perpieke me i rrejte organet e pushtetit dhe komisjonet, tue thane se, gjoja per shkak te barit te keq, korrja e sivjeme nuk asht e mire Disa komisjone vendesh jane influencue nga rrenat e kettila te kulakve dhe te çmuemit e drithnave nuk asht ba real. Per kete arsye disa komisione vendesh jane riorganizue. Mbas ketij riorganizimi asht konstatue se prodhimi asht 1700-1800 kg-grune per nji hektar dhe 600 kg. ma i madh se ne vjetin e kaluem. Sikurse te çmuemit e drithat t'ishte ba me kohe dhe si mbas gjendjes se vertet te prodhimit, sigurisht edhe plani i kontraktimit nuk do t'ishte mbete pa u-realizue deri tash. Kjo asht nji nga arsyenat kryesore qe kontraktimi nuk ka shkue mire ne kete rreth. N'anen tjeter, duket se as Dekreti nuk asht skjarue mire dhe se puna e aktivave t'agjitatorve nuk ka qene ne naltsin e duhun.

Tue qene se ne keto dite do t'iu komunikohet katundarve te çmuemit e prodhimit, qe do te jete nji nxitje per kontraktim, mbassi ky do te zgjatë deri ne fillimin e blemjes se detyrueshme, asht e nevojshme, qe pervec organeve perkatse, t'aktivizohen edhe aktivet e agjitatorve, ne menyre qe kontraktimi te shpejtesohet dhe plani i parapame te plotsohet. Duhet te punohet veç e veç me çdo shtepi dhe te banet nji lufte e vazhdueshme per t'i binde me kontraktue, mbassi kjo asht ne te miren e prodhuesve dhe se te gjitha avantazhet e Dekretit mund te çrytzohen vetem me kontraktim para se me fillue blemja e detyrueshme. Puna individuale me çdo ekonomi shtepiake kishte me sjelle si perfundim jo vetem realizimin por edhe tejkalimin e planit te kontraktimit, mbassi vetem keshtu katundaret dot te mujne me i perfitue te gjitha te mirat qe u jep Dekreti, çka konkretisht don me thane me e permirsue standardin jetsuer te njerezve t'one punuesa te katundit. Tue qene se çashtja e kontraktimit asht nji çashtje me randesi te madhe e nji mase e pushtetit popullor ne dobi te katundarve, duhet t'i kushtohet kujdes i duhun dhe te bahet çmos qe plani i kontraktimit te realizohet sa ma pare.

Lajme te shkurta

Athine, 8 korrik

Radjostacioni i Greqis se lire lajmron se njesinat e Armates Demokratike greke sulmuen anmikun ne sektorin e Kletist. Ne ket rast anmiku monarko-fashist la 30 te vdekun. Jane zane sasina te mdhaja materjali luftarak, nji aparat radio-telegrafik, dy mortaja dhe 20 pushke.

Njisit e Armates Demokratike sulmuen, me 3 korrik, banden e deputetit t'Athines, Papadobullos, dhe kompanin e «gardes nacionale» ne teritorin e Ksirovunes n'Epir. Anmiku la 27 te vdekun, 7 te plagosun e 13 u zuen rob. U kapen sasina te mdhaja materjali luftarak. Ne ket sektor asht shkaterrue dhe rruga Janine-Jgumenice.

Ne Rumeli e Antilohi njesit e Armates Demokratike kane thye rezistencen e anmikut dhe e kane detyrue me hike. Forcat e Armates Demokratike kane vazhdue perparimin.

Gjate muejit qershuer vetem ne terenin e Maqedonis lindore-Thrakis anmiku ka lane 25 te vdekun, 338 te plagosun dhe 23 jane zane robe. Jane hedhe n'ajr 3 kompozicjone hekurudhore, asht asgjasue nji tenk, nji aeroplan 13 kamjona, jane thye 3 ura.

FRANCE:

Pariz, me 8 korrik

Ne Marsej marinaret kane shpalle greve. Greva ka perfshi te gjithe marinaret e anijeve te kompanis "Transatlantik" e cila vepron ndermjet Frances dhe Afrikes Veriore.

"Ky aksion i marinerve paralizon lidhjet detare e tregtare ndermjet Metropolit e Algjeris bash ne momentin kur komunikacjoni asht ma i nevojshem ne ket drejtim, thekson Ministrija e komunikacjonit.

ITALI

Qeverija e de Gasperit perpiqet me te gjitha menyrat per t'a ndalue valen e levizjes greviste n'Itali. Keshilli ministruer, siç shkruen fletorja „Popolo" tregoj se ka per qellim me e pengue me ligje levizjen nen pretekstin se grevat e fundit kane pase „karakter politik".

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Popullor Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.